

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata Supreme në Brazil shqyrton kërkesën e Shqipërisë për Ervin Matën/ 'Dritë jeshile' për ekstradim n e tij
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/gjykata-supreme-ne-brazil-shqyrton-kerkesen-e-shqiperise-per-ervin-maten-i586317
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:05:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d6dce2987f4e6a7ae7d75962e0d0fb0c1ffa344deebcfab01d48f005b3a69d4b
TEKSTI	483a4a3de7fb24fe67eb278b1bf9dc9db54c9e73797ff12a0e5d07936a207ee1
PAMJA	28dc024cd291600d5dc13f8ad3ff840aeb2b3b1862996bc765da55be1df558ca

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2ce10d3ed226397a62c429737af05d15dbe8825c93774be4b1971cc379f3b2d1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4768c0741a99d31c0c1ea2cb7e5bc9dc39124f7af2f5dea963bef58ba2da55aae
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/2ce10d3ed226397a62c429737af05d15dbe8825c93774be4b1971cc379f3b2d1

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by  [Kontakt](#)



 [English](#)



1 e [Frika nga tensionet per vendimin ndaj krereve te UCK, dy avione te KFOR-it arrijne ne Kosove](#)[Berishes i du ket SHBA 'lavatrice' qe flet ne emer te Trump pas kthimit?](#)[Drej fundit](#)

Gjykata Supreme në Brazil shqyrton kërkesën e Shqipërisë për Ervin Matën/ ‘Dritë jeshile’ për ekstradimin e tij



15 Shtator 2026, 19:15Kronika TEMA



Ervin Mata është në procedurë ekstradimi në Brazil pas kërkesës së paraqitur nga autoritetet shqiptare.

Sipas vendimit të Gjykatës Supreme të Brazilit, Shqipëria ka kërkuar ekstradimin e Matës për vepra penale që lidhen me trafikun e narkotikëve, organizatën kriminale dhe grupin kriminal të strukturuar.

Gjykata bën me dije se ndaj Ervin Matës ishte urdhëruar masa e paraburgimit më 11 mars 2025, ndërsa Policia Federale braziliane njoftoi më 27 prill 2026 për ekzekutimin e urdhrit të arrestit. Sipas dokumentit, arrestimi i tij u krye më 25 prill 2026.

Pas arrestimit, në Brazil u zhvilluan procedurat për marrjen në pyetje të tij. Seanca e parashikuar fillimisht për 13 maj 2026 u shty për 20 maj, ndërsa më 22 maj Gjykata Federale e Avaré/SP njoftoi për zhvillimin e marrjes në pyetje.

Më 17 qershor 2026, mbrojtja e Ervin Matës paraqiti përgjigje me shkrim dhe kërkoi rrëzimin e kërkesës për ekstradim. Ndërkohë, Prokuroria e Përgjithshme e Brazilit u shpreh në favor të pranimit të kërkesës së Shqipërisë për ekstradim.

Megjithate, me 2 korrik 2026, Ministria e Drejtësisë së Brazilit i percolli gjykates nje Note Verbale te Ambasades se Shqiperise, se bashku me dokumentacionin qe formalizon kërkesën për ekstradimin e Ervin Matës.

Bëhet fjalë për kërkesën për ekstradim të paraqitur nga Qeveria e Shqipërisë ndaj ERVIN MATËS, shtetas shqiptar, mbi bazën e parimit të reciprocitetit për raste të ngjashme.

Ministria e Drejtësisë dhe Sigurisë Publike ka përcjellë Shënimin Teknik nr. 34/2025/EXT/CGETPC/DRCI/SENAJUS/MJ, ku informohet se personi për të cilin kërkohet ekstradimi “kërkohet për kryerjen e veprave penale të trafikut të narkotikëve, veprave penale të organizatës kriminale dhe grupit kriminal të strukturuar, sipas parashikimeve të neneve 283/a, 28/4, 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”.

Më 11 mars 2025, urdhërova caktimin e masës së paraburgimit ndaj Ervin Matës.

Më 27 prill 2026, Policia Federale njoftoi këtë Gjykatë Supreme për ekzekutimin e urdhrit të arrestit. Arrestimi i personit të kërkuar për ekstradim u krye më 25 prill 2026 dhe, pasi u përmbushën formalitetet e tjera për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim, në përputhje me nenin 209 të Rregullores së Gjykatës Supreme Federale, u caktua për 13 maj 2026, ora 10:00, seanca për marrjen në pyetje të Ervin Matës, në ambientet e Gjykatës Federale të Seksionit Gjyqësor të Shtetit të São Paulos.

Kjo seancë u shty për 20 maj 2026, ora 10:00, në ambientet e Gjykatës Federale të Seksionit Gjyqësor të Shtetit të São Paulos.

Më 22 maj 2026, Gjykata Federale e Shkallës së Parë në Avaré/SP njoftoi për zhvillimin e marrjes në pyetje të personit që kërkohet për ekstradim.

Më 17 qershor 2026, mbrojtja paraqiti përgjigjen me shkrim dhe kërkoi refuzimin e kërkesës për ekstradim.

Pas shqyrtimit të akteve, Prokuroria e Përgjithshme e Republikës paraqiti qëndrimin e saj në favor të pranimit të kërkesës për ekstradim të paraqitur nga Qeveria e Shqipërisë ndaj shtetasit shqiptar Ervin Mata.

Më 30 qershor 2026, mbrojtja e Ervin Matës paraqiti kërkesë për “revokimin e paraburgimit për qëllime ekstradimi”, të vendosur ndaj tij, pa cenuar mundësinë e vendosjes së masave të tjera të përshtatshme, në përputhje me specifikat e rastit konkret.

Në thelb, mbrojtja argumenton se shteti shqiptar nuk e ka formalizuar kërkesën për ekstradim brenda afatit 60-ditor, të parashikuar në ligjin brazilian për migracionin, pas vendosjes së paraburgimit.

Më 2 korrik 2026, aktet iu përcollën Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës për qëndrim.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Zjarr në një fshat në Gjirokastrë, rrezikohen banesat

16:55 Kronika

["Ruga e kokainës" drejt Durrësit, 38 ditë në det, nga Brazili, përmes Marokut e Greqisë](#)

16:45 Kronika

[U arrestua në Belgjikë/ Kush është Jasin Avdyli, i përfshirë në dosjen Vol-Vo 4 e laboratorin e heroinës në Has](#)

15:05 Kronika / 3 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.